ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-24-97-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" RENER " SH.P.K.**
NUI	**810828220**
Adresa	**Rr. Hamdi Mramori**
Vendi	**PRISHTINA**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Jetik Krasniqi**
Adresa elektronike	**shpkrener@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**29.04.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender-loto 1[]Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender-loto 2

Njoftim për Kontratë: 11.01.2024

Afati i fundit për dorëzim te ofertave: 22.01.2024

Kërkesa për rishqyrtim: 28.02.2024

Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim:04.03.2024

Njoftim i dytë mbi vendimin e autoriteti kontraktues: 08.04.2024

Kërkesa e dyte për rishqyrtim: 12.04.2024

Vendimi mbi kërkesën e dyte për rishqyrtim:18.04.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim pranë AK, date 12.04.2024, vendimi i AK për refuzim te kërkesës për rishqyrtim, date 18.04.2024.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

a) Neni 6 i LPP-së
b) Neni 52.3 i LPP-së
c) Neni 59.4 i LPP-së
d) Neni 62 i LPP-së
e) Neni 7 i LPP-së
f) Neni 51 i LPP-së
g) Neni 54 i LPP-së
h) Neni 56 i LPP-së
i) Neni 108/A, par. 6 LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues (këtu e tutje AK), në Vendimin e datës 18/04/2024, për tenderin me titull 'Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender lot 1' dhe me numër '616-24-97-2-1-1', ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e:

a) Neni 6 i LPP-së
b) Neni 52.3 i LPP-së
c) Neni 59.4 i LPP-së
d) Neni 62 i LPP-së
e) Neni 7 i LPP-së
f) Neni 51 i LPP-së
g) Neni 54 i LPP-së
h) Neni 56 i LPP-së
i) Neni 108/A, par. 6 LPP-së

për shkak se:

SFONDI I NGJARJES
1. Më datë 12/04/2024, ne si Operator Ekonomik kishim dërguar Kërkesën tonë për Rishqyrtim. Kërkesa jonë për Rishqyrtim përmbante pretendime ankimore si në vijim:

a) Kemi cituar dispozitat ligjore të shkelura nga AK me Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, e të cilat janë: Nenet 6, 52, 59 dhe 62 të LPP
b) Kemi dërguar si provë Aneksin 1, të nënshkruar dhe të vulosur, së bashku me argumentet dhe arsyet se pse nuk duhet të anulohet LOT 1.
c) Kemi identifikuar shkeljet ligjore të AK në raport me vlerësimin e tenderëve.
d) Kemi identifikuar shkeljet ligjore të AK lidhur me shpërblimin me kontratë një Operatori Ekonomik të shtrenjtë.
e) Kemi identifikuar shkeljet ligjore të AK lidhur me anulimin e prokurimit për LOT 2.

Andaj, gjeni të bashkëngjitur si provë Kërkesën tonë për Rishqyrtim.
Provë: Kërkesa për Rishqyrtim e datës 12/04/2024

Megjithatë, AK – FARE NUK TRAJTON Kërkesën tonë për Rishqyrtim, dhe e DEVIJON tërësisht të njëjtën, duke na imponuar neve si Operatorë Ekonomik që të zgjerohemi dhe elaborohemi në Ankesën tonë.
Andaj, me mirësjellje, konsideratë dhe bazuar në etikën profesionale për luftimin e veprimeve të kundërligjshme të AK – kërkojmë nga OSHP që të trajtoj këtë Ankesë tonë, ani pse ndryshon nga Kërkesa jonë për Rishqyrtim.

A N K E S A

1. AK në faqen 2 dhe 3 të Vendimit mbi Kërkesën për Rishqyrtim dt. 17/04/2024, argumenton në mënyrë lajthitëse atë që nuk është pretenduar nga ne, në Kërkesën tonë për Rishqyrtim të datës 12/04/2024. Kjo SEPSE, AK në Formularin B58 – Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, gjegjësisht Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, arsyen për eliminim e ka dhënë kësisoji:

citat
"Nuk ju keni përmbajtur specifikimeve teknike të detyrueshme në Aneksin 1
Me fokus të veçantë, nuk ka ofruar përmbajtje të njësive mësimore të listuara konform kurrikulës së Kosovës, përkatësisht nuk ka njësi mësimore të vendosura në një bibliotekë digjitale në formë të një software elektronik të dedikuar dhe të sigurt online dhe offline"
mbarim citati
Ndërsa, Kërkesa jonë për Rishqyrtim e datës 12/04/2024 ka faktuar dhe vërtetuar të kundërtën e asaj që AK ka deklaruar në arsyetimin e eliminimit përmes. Pra, kemi dërguar si provë Specifikimet Teknike – Aneksi 1 të nënshkruara, të vulosura. Duke vepruar kështu, AK vepron në kundërshtim me nenet 7, 51, 54 dhe 56.

2. AK vepron kundërligjshëm edhe me Nenin 108/A, par. 6, sepse vazhdon me shkeljet e saj duke mos elaboruar ASPAK thelbin e pretendimeve tona në Kërkesën për Rishqyrtim, por NË TËRËSI DEVIJON pretendimet tona dhe krijon situatë lajthitëse. Kjo sepse nuk fokusohet askund në shtjellimin e asaj që kemi pretenduar lidhur me Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme.

3. Më tutje, AK vepron në kundërshtim me Nenin 6, sepse pretendimet tona të tjera shpërblimin me kontratë të operatorit më të shtrenjtë ekonomik dhe lidhur me anulimin e

aktivitetit për LOT 2 – nuk i merr parasyshë, nuk i shtjellon e nuk i arsyeton fare.

4. AK, refuzimin e Kërkesës tonë për Rishqyrtim e bazon në dispozitat ligjore të neneve 62 dhe 63 të RRPP, dhe me ç'rast vepron në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së për shkak që refuzimi, rrjedhimisht vendimi nuk është marrë për arsyet që specifikohen në Rregullore (neni 62 dhe 63). Pra, AK ka cilësuar gabimisht situatën faktike dhe të drejtën materiale.

5. Megjithatë, për dijeninë e AK, ASKUND në bazën ligjore të prokurimit publik, qoftë ajo LPP, RRPP apo Udhëzuesi – nuk përmendet që paramasa/ÇMIMi është determinues në vlerësimin e tenderëve, gjegjësisht eliminimin e Operatorëve Ekonomik (përjashto këtu rastet kur nuk përmbushet kushti i çmimit më të vogël, apo çmimit ekonomikisht më të favorshëm). Pra, AK me arsyetimin e saj, ka devijuar në mënyrë të plotë pretendimet tona, dhe ka sjellë situatë tjetër, situatë kjo inekzistente, dhe si rrjedhojë, në bazë të dispozitave ligjore të nenit 52 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është vendim i paligjshëm, dhe rrjedhimisht ky Vendimi i AK duhet të bëhet NULE.

Marrë parasyshë të lartpërmendurat, dhe marrë parasyshë që pretendimet tona ankimore qëndrojnë të njëjta dhe se dëshirojmë që ato të trajtohen nga AK sipas dispozitave ligjore të kërkojmë nga OSHP që të marrë

VENDIM
a) TË OBLIGOJ AK që të shfuqizoj Vendimin e datës 18/04/2024
b) Të kthej lëndën në AK për RIVLERËSIM
c) RIVLERËSIMI të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demetet materiale rreth 3,500.00 Euro

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*